

Nr. K1/I51-10 Prot.
Nr. Dok. 2025002905/10

Tiranë 04.11.2025

Lënda: Rekomandohet hartimi dhe miratimi i një procedure të brendshme, që të garantojë transparencë, paanësi dhe përfaqësim real të shoqërisë civile në Komisionin për Njohjen e Pakicave Kombëtare

KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBETARE

Të nderuar,

Në vijim të mbledhjes së parë të Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, një strukturë e ngritur në zbatim të akteve nënligjore në kuadër të ligjit nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, siç jeni informuar edhe më herët, nga organizatat e shoqërisë civile është prezantuar në media, shqetësimi mbi përbërjen e këtij komisioni. Në këto kushte, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kemi filluar ndjekjen e kësaj çështje. Për këtë qëllim, kemi zhvilluar një hetim administrativ, në kuadër të të cilit i jemi drejtuar me kërkesa për shpjegime dhe dokumentacion, ndër të tjera, edhe Komitetit për Pakicat Kombëtare.

Konkretisht, me tonën nr. K1/I51-7, dt. 11.08.2025 drejtuar Komitetit për Pakicat Kombëtare (KPK) kemi kërkuar informacion lidhur me procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e organizatave të shoqërisë civile që marrin pjesë në Komision, konkretisht për metodologjinë, kriteret e përdorura si dhe çdo

akt, udhëzim apo vendimmarrje që ka orientuar këtë proces, duke na vendosur në dispozicion dokumentacionin zyrtar që dëshmon procedurën e ndjekur për këtë përzgjedhje.

Me shkresën nr. 190/1, datë 22.08.2025, Komiteti për Pakicat Kombëtare ka sqaruar se VKM nr. 845/2024 përcakton vetëm kriterin që përfaqësuesit e shoqërisë civile në Komision të jenë OJQ që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, por nuk parashikon procedurë apo metodologji të posaçme për përzgjedhjen e tyre. Sipas KPK, përzgjedhja e tre përfaqësuesve është bërë mbi bazën e kontakteve të vazhdueshme me OJQ-të, duke marrë parasysh eksperiencën, legjitimitetin, përfaqësueshmërinë dhe reputacionin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare.

Organizimi dhe funksionimi i Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare rregullohet nga ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave, konkretisht Vendimi nr. 843, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare” dhe Vendimi nr. 845, datë 26.12.2024 “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”. Ky komision ngrihet pranë Ministrisë së Brendshme dhe ka për qëllim të shqyrtojë kërkesat për njohjen formale të pakicave të reja kombëtare, si dhe kërkesat individuale për vetëidentifikim si pjesë e një pakice. Përbërja e tij është ndërinstytucionale dhe përfshin përfaqësues nga disa ministri dhe institucione, si dhe përfaqësues të Komitetit për Pakicat Kombëtare e të shoqërisë civile. Qëllimi kryesor i këtij organi është të garantojë një proces ligjor, transparent dhe të bazuar në kriterë objektive për njohjen dhe mbrojtjen e identitetit të pakicave kombëtare, duke respektuar të drejtën e vetëidentifikimit dhe duke siguruar një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës në vendimmarrje.

Siç u theksua më lart, Komiteti i Pakicave Kombëtare, në qëndrimin e përcjellë pranë Avokatit të Popullit, ka mbajtur qëndrimin se VKM nr. 845/2024 nuk përcakton një procedurë të posaçme për përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, por vetëm kriterin e përgjithshëm që ata të jenë OJQ që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare.

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 26.12.2024, në pikën 3 parashikohet se në përbërjen e Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare përfshihen katër përfaqësues nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, ku njëri prej tyre duhet të jetë përfaqësues i pakicës kombëtare që kërkon të njihet, sipas rastit, si dhe tre përfaqësues nga shoqëria civile, të propozuar nga KPK nga radhët e OJQ-ve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

Së pari, Avokati i Popullit vlerëson se mosrregullimi i një procedure të posaçme në VKM nr. 845/2024 nuk duhet të interpretohet si pengesë apo kufizim për hartimin dhe zbatimin e një procedure të brendshme nga Komiteti për Pakicat Kombëtare. Përkundrazi, kjo krijon mundësinë që institucioni, në ushtrim të rolit të tij këshillimor dhe bashkërendues, të formalizojë rregulla të qarta që garantojnë transparencë, paanësi dhe trajtim të barabartë të organizatave të shoqërisë civile. Vetë fakti që ligjvënësi ka përcaktuar vetëm kriterin e përgjithshëm që përfaqësuesit të jenë OJQ që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, nënkupton domosdoshmërinë e konkretizimit të këtij kriteri përmes një metodologjie të dokumentuar; përndryshe ai mbetet i pavërtetueshëm në praktikë.

Së dyti, mungesa e një procedure të formalizuar rrezikon të krijojë perceptimin e një përzgjedhjeje subjektive, të mbështetur vetëm mbi praktika të pashkruara, ndërkohë që synimi i ligjit dhe i akteve nënligjore është sigurimi i një përfaqësimi real, të paanshëm dhe të bazuar në kritere të qarta. Për këtë arsye, Avokati i Popullit vlerëson se është e domosdoshme që KPK të hartojë dhe miratojë një procedurë të brendshme administrative, e cila të rregullojë në mënyrë transparente dhe të verifikueshme procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Komisionin për Njohjen

e Pakicave Kombëtare. Po ashtu, është e rëndësishme që ky mekanizëm të bëhet publik, për të garantuar barazi dhe besueshmëri. Një procedurë e tillë do të garantonte që vendimmarrja të mos mbështetet në praktika rastësore apo në vendime të pashkruara, por në rregulla të qarta, të njohura dhe të zbatueshme njësoj për të gjithë aktorët.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në vijim të nenit 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se *“Avokati i Popullit është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend”*, si dhe të nenit 21, germa “b”, ku thuhet shprehimisht se *“pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit ... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave nga Komiteti për Pakicat Kombëtare për hartimin dhe miratimin e një procedure të brendshme të qartë, që të garantojë transparencë, paanësi dhe përfaqësim real të shoqërisë civile në Komisionin për Njohjen e Pakicave Kombëtare.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.